



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 10031 Prot.
15

Tiranë, më 28.06 2022

V E N D I M

Nr. 58 Dt. 28.06 2022

PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 25, gërma d), në Vendimin e Senatit nr. 2, datë 13.01.2022, “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2022”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 4, datë 17.01.2022 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2022”, në shkresën e MAS me Nr. 558/1 Prot., datë 23.05.2022 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar” ,” , në Vendimin e Rektoratit nr. 29, datë 06.06.2022 “Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.06.2022,

V E N D O S I :

1. Miratimin e lëvizjes paralele të personelit akademik nga njësitë kryesore të FSHL, FVFR dhe IKSHS në FSHR, pa prekur strukturën dhe organikën e tyre për të plotësuar organikën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe disa ndryshime në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
 - **Prof.Dr. Robert Çina**, me detyrë Dekan i FSHR, personel akademik në Departamentin e Disiplinave Biomjekësore dhe Humane, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Vjollca Shpata**, Profesor i Asociuar në Departamentin e Kineziologjisë, FSHR, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Mirjeta Cenaj**, Lektore në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Jonida Peppo**, Asistent Lektore në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë, IKSHS, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.

- **Z. Erion Bala**, Asistent Lektor në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Ornela Marko**, Asistent Lektore në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit, FVFR, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Suela Xhufi**, Asistent Lektore në Departamentin e Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit, IKSHS, kalon në strukturë në Departamentin e Rehabilitimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Z. Orest Shytaj**, Asistent Lektor në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë, IKSHS, kalon në strukturë në Departamentin e Disiplinave Biomjekësore dhe Humane, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Z. Aldo Muçalliu**, Asistent Lektor në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë, IKSHS, kalon në strukturë në Departamentin e Kineziologjisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
 - **Znj. Klotilda Vrenjo**, nga “Lektor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes kalon “Profesor i Asociuar” nga data 25.03.2022 e në vazhdim.
 - Pagesa e **Znj. Klotilda Vrenjo**, do të jetë sipas VKM Nr. 268, datë 29.03.2017, “Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Lidhja nr.1, Nr. Rendor 12, Pozicioni “Profesor i Asociuar”.
 - Përsonelele akademik “Asistent Lektor” në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon në strukturë “Lektor”.
2. Listë prezence do të firmoset nga të dyja palët, FSHL, FVFR, IKSHS dhe FSHR nga data 01.06.2022 e në vazhdim.

Kjo lëvizje paralele nuk sjell efekte financiare apo ndryshime në ngarkesën mësimore, të planifikuara sipas marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL.

3. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

